



KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 626-23-6372-2-2-1/C146

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të Sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

Dhe

Grupi i Operatorëve Ekonomik ALPO SH.P.K. me nr. të biznesit: 811255117 selia në Prishtinë dhe Enggroup SH.P.K. me nr. të biznesit 810502759 selia në Prishtinë, të cilët në bazë të autorizimit i përfaqëson z. Fidan Salihu në cilësinë e Arkitektit të O.E. ALPO SH.P.K. (në vazhdim "Kontraktuesi") në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punët e shënuara më poshtë:

Titulli i Kontratës: "HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITET 2023-2026"-Ritender me numër identifikues të prokurimit: 626-23-6372-2-2-1 dhe numër të brendshëm: 626-23-005-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate ka të bëjë me hartimin e projekteve ideore - duke përfshi edhe inçizimin e gjendjes ne teren, hartimin e projekteve kryesore - palir - duke përfshi edhe inçizimin e gjendjes në teren, hartimin e projekteve për renovim - duke përfshi edhe inçizimin e gjendjes në teren, hartimin e projekteve për terrene sportive të hapura - duke përfshi edhe inçizimin e gjendjes në terren, hartimin e projekteve për rrugë dhe objektet e rrujës - duke përfshi edhe inçizimin e gjendjes në terren, hartimin e projekteve për trajtim te ujërave - duke përfshi edhe inçizimin e gjendjes në terren, hartimi e projekteve për rrjetet elektrike, ndriçimet publike - duke përfshi edhe inçizimin e gjendjes në terren, punimin e elaborateve për nevoja të Autoritetit Kontraktues (Varësisht prej detyrës projektuese dhe nevojave të AK) në Mamushë sipas detyrës projektuese të dhënë në dosjen e tenderit, duke kryer shërbimet në vijim nga ana e Kontraktuesit:

DETÝRË PROJEKTUESE

PËR HARTIMIN E PROJEKTEVE PËR KOMUNËN E MAMUSHËS

Kërkohet ofrimi i shërbimit në projektim të: rrugëve, rrugëve fushore, rrjetit të kanalizimit fekal, rrjetit te kanalizimit atmosferik dhe kanaleve te hapura, objekteve shkollore, objekte kulturore, sportive, parqeve,varezave, te ngrohjes qendrore neper shkolla si dhe projektimi i ndriqimit.

Standartet e projektit dhe kriteret:

Për ofrimin e shërbimit në projektim të: rrugëve, rrugëve fushore, rrjetit të kanalizimit fekal, rrjetit te kanalizimit atmosferik dhe kanaleve te hapura, objekteve shkollore, objekte kulturore, sportive, parqeve, te ngrohjes qendrore neper shkolla si dhe projektimi i ndriqimit, duhet të përdoren standartet teknike evropiane dhe rregullativa ligjore në fuqi dhe duhet të bëjë përgatitjen e projektit të plotë sipas normave dhe standardeve për llojin e punës që kërkohet.

Gjatë hartimit të projektit, projektuesi duhet gjithsesi t'i përmbahet ligjeve aktuale në fuqi, si:

- Ligjit mbi ndërtimin të Kosovës 04/L-110

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.



- Ligjit mbi rrugët të Kosovës
- Ligjeve dhe rregulloreve mbi mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjes në punë.
- Ligjit hapësinor të Kosovës
- Ligjit mbi shpronësimin

Projektuesi duhet t'i përbahet detyrës projektuese të dhanë nga menaxheri i kontratës, por projektuesit i lejohet të propozoj edhe elemente që nuk janë cekë në detyrën projektuese dhe të njëjtat e begatojnë dhe i dhënë funksion më të mirë projektit, por për të njëjtat duhet të merret pëlqimi nga menaxheri i kontratës.

Projektet duhet të përbajnë :

- **PJESA TEKSTUALE**

- Të dhënat e kompanisë projektuese,
- Licencat e kompanisë dhe projektuesve,
- Vendimet, kontratat e emërimit të menaxherit të projektit dhe projektuesve,
- Deklaratat e pjesëmarrësve në projekt se projekti është punuar në bazë të normave dhe standardeve,
- Kontrata me detyrë projektuese,
- Te dhënat e përgjithshme për projektin,
- Lënda e projektit,
- Paraqitura e shënimive gjeodezike, gjeologjike, gjeomekanike dhe hidrologjike,
- Përshkrimi i hollësishëm teknik (për te gjitha fazat),
- Llogaritjen e të gjitha elementeve të objekteve për intervenim,
- Llogaritjet teknike për te gjitha fazat,
- Paramasa dhe parallogarit,
- Përshkrimi dhe studimi për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe ndikimi i objektit në mjeshtëri i mbrojtjes së mjedisit .
- Elaboratin gjeomekanik,
- Fiziken ndërtimore,
- Elaboratin kundër zjarrit etj.
- Elaboratin për mbrojtje të mjedisit.

Sipas kategorizmit të projekteve disa prej këtyre kushteve të permenduara me lartë nuk vlejnë.

1. Projektimi i rrugëve.

Kërkohen të gjitha fazat e projektit, duke përfshirë edhe inçizimin gjeodezik të terrenit dhe elaboratet e nevojshme (gjeomekanikë, mbrojtje të mjedisit, etj). Gjatë projektimit duhet të kohen parasysh kërkesat e Komunës së Mamushës (zyrtarit përgjegjës për projektin –menaxherit të kontratës). Gjatë projektimit duhet te ketë parasysh dhe përdorimi i materialeve te përshtatshme me terenin dhe te gjindshme ne tregun vendor. Bazë e projektimit duhet të mirren bazat e projektuese europiane si dhe të zbatohen dispozitat e gjithëmbarshme të projektimit të rrugëve sipas kategorizimit të tyre.

Si u theksua me sipër vlen për projektimin e rrugëve fushore dhe rrugicave të ndryshme.

○ PJESA GRAFIKE

- Përshkrimi teknik dhe kushtet teknike
- Inçizimi gjeodezik
- Situacioni i trasës me P: 1: 200, 1:500 apo 1:1000
- Profili gjatësor me P:1:100/1000
- Profilet tërthore me P:1:50
- Profilet karakteristike me P:1:20
- Detalet për ekzekutim të lëshesave
- Llogaritjet e kthesave horizontale, llogaritjet dinamike të automjeteve, dimensionimi i shtresave të rrugës ku hyjnë shtresa bartëse dhe shtresat e asfaltit apo mbistruktura me kubëza
- Situaconi i sinjalizimit horizontal dhe vertikal në P=1:1000
- Detalet e sinjalizimit horizontal dhe vertikal, si dhe te gjitha pjesët përbërse të nevojshme të rrugës.
- Paramasa dhe parallogarit

2. Projektimi i rrjetit të kanalizimit fekal

Gjatë projektimit të një sistemi të kanalizimit fekal paraqiten këto faza: studimi, inçizimin gjeodezik, zgjidhja ideore, projekti ideor dhe projekti kryesor, zbatues. Të regjistrohet gjendja e objekteve në terenë (nëse ka: rrjete te kanalizimit ekzistues, objekt për pastrim të ujit, kolektorët, pusetat etj) raporti gjeologjik dhe hidrologjik.

○ PJESA GRAFIKE

- Përshkrimi teknik dhe kushtet teknike
- Llogarit hidraulike
- Koordinatat e fundit të kanalit
- Inçizimi gjeodezik
- Situacioni i projektit për vendin ku ndërtohet kanalizimi me P: 1: 200, :500 apo 1:5000
- Prerja gjatësore e kolektorit me elementet gjeologjike dhe hidrogjeologjike P:1: 100, :1000
- Profili tërthor karakteristik P:1: 50
- Pusetat kontrolluese me të gjitha detalet P:1: 50
- Projekti për mbrojtjen në punë (detale e sigurisë të kanalit)
- Paramasa dhe parallogarit

3. Projektimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe kanaleve të hapura

Gjatë projektimit të një sistemi të kanalizimit atmosferik paraqiten këto faza: studimi, inçizimin gjeodezik, zgjidhja ideore, projekti ideor dhe projekti kryesor, zbatues. Të evidentohet



problematika e ujërave atmosferik, ku do të ndërtohet rrjeti i ri i ujërave, si dhe do të riparohen disa pjesë ku nuk është funksionale. Të kihet parasysh se kanalet e hapura do të punohen tek rrugët e përfunduara ku duhet të jipet zgjidhja më e përshtatshme dhe më ekonomike.

○ PJESA GRAFIKE

- Përshkrimi teknik dhe kushtet teknike
- Kordinatat e fundit të kanalit
- Inçizimi gjeodezik
- Situacioni i projektit për vendin ku ndërtohet kanalizimi atmosferik me P: 1: 200, :500 apo 1:5000
- Prerja gjatësore e kolektorit me elementet gjeologjike dhe hidrogjeologjike P:1: 100, :1000
- Profili tërthore dhe karakteristike P:1: 50
- Pusetat kontrolluse me të gjitha detalet P:1: 50
- Projekti për mbrojtjen në punë (detale e sigurisë të kanalit)
- Detalet punuese të leshesave ku do të realizohet shpimi në rrugë. Pasiqë rrugët janë të asfaltuara P: 1: 50
- Paramasa dhe paralogarit

4. Objekte kulturore, qendër rimore dhe objekte shkolllore

Gjatë projektimit te ndërtesave te reja duhet te kihen parasysh te gjitha rregullat, ligjet ne fuqi dhe rregulloret e ndryshme te Komunës se Mamushës.

Fryma arkitektonike që do te përdorët në projektimin e këtyre ndërtesave duhet te jetë inovative, të përshtatet me ambientin dhe terrenin ku ndodhet duke nxjerre ne pah vlerat e zonës ku ndërtohet.

Gjatë projektimit te ndërtesave te reja duhet te merret parasysh dhe te jete ne vëmendje te projektuesit qasja në objekt mënyrë që të jetë e përshtatshme për të gjitha grup moshat dhe njerëzve me nevoja te veçanta si dhe tjera që kërkojnë normat dhe standartet për atë lloj projekti .

○ PJESA GRAFIKE

- Përshkrimi teknik dhe kushtet teknike
- Situacioni i gjërë.
- Plani i situacionit të ngushtë në shkallë 1: 200, 1:500 apo 1:1000
- Inçizimi gjeodezik
- Bazat dhe prerjet 1:50
- Dukjet dhe perspektiva,
- Detalet 1:5; 1:10, 1:20,;
- Llogarinë statike, bazat dhe prerjet ne përpjesë 1:50; 1:25 detalet e kallupimit dhe detalet e armimit 1:20;1:25

- Projektimi i instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit me të gjitha fazat, bazat, prerjet dhe të gjitha detalet e nevojshme (Pjesët fazonike)
- Projektimi i instalimeve tërrjetit të elektrikës me të gjitha detalet e nevojshme
- Projektimi i instalimeve e rrjetës së teknologjisë informative (IT), telefonisë dhe kamerave me të gjitha detalet e nevojshme
- Projektimi i instalimeve të makinerisë me të gjitha detalet e nevojshme
- Paramasa dhe parallogarit

5. Objekte Sportive

Projekti i objekteve sportive perfshin projektin i stadiumit dhe pjeset tjera per rekreacion. Gjatë projektimit te ndërtesave te reja duhet te merret parasysh dhe te jete ne vëmendje te projektuesit qasja në objekt në mënyrë që të jetë e përshtatshme për të gjitha grup moshat dhe njerëzve me nevoja te veçanta si dhe tjera që kërkojnë normat dhe standartet për atë lloj projekti .

○ PJESA GRAFIKE

- Përshkrimi teknik dhe kushtet teknike
- Situacioni i gjërë.
- Plani i situacionit të ngushtë në shkallë 1: 200, 1:500 apo 1:1000
- Inçizimi gjeodezik
- Bazat dhe prerjet 1:50
- Dukjet dhe perspektiva,
- Detalet 1:5; 1:10, 1:20,:;
- Llogarinë statike, bazat dhe prerjet ne përpjesë 1:50; 1:25 detalet e kallupimit dhe detalet e armimit 1:20;1:25
- Projektimi i instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit me të gjitha fazat, bazat, prerjet dhe të gjitha detalet e nevojshme (Pjesët fazonike)
- Projektimi i instalimeve të rrjetit të elektrikës me të gjitha detalet e nevojshme
- Projektimi i instalimeve e rrjetës së teknologjisë informative (IT), telefonisë dhe kamerave me të gjitha detalet e nevojshme
- Projektimi i instalimeve të makinerisë me të gjitha detalet e nevojshme
- Paramasa dhe parallogarit

6. Projektimi urave

Kërkohen të gjitha fazat e projektit, duke përfshirë edhe inçizimin gjeodezik të terrenit dhe elaboratet e nevojshme (gjeomekanikë, mbrojtje të mjedisit,etj). Gjatë projektimit duhet të kihen parasysh kërkesat e Komunës së Mamushës (zyrtarit përgjegjës për projektin –menaxherit të kontratës). Duhet të kihet parasysh se do të ndërtohen ura të reja si dhe do të rikonstruktohen urat e vjetra sipas nevojës.

○ PJESA GRAFIKE

- Përshkrimi teknik dhe kushtet teknike
- Inçizimi gjeodezik

- Përcaktimi i aksit gjatësor të urës P: 1: 200, 1:500
- Përcaktimi i niveletës së urës P: 1: 200, 1:500
- Përcaktimi i gjerësisë së urës P: 1: 200, 1:500
- Përcaktimi i hapsirës prurëse
- Analiza kimike e ujit të rrjedhjës dhe ujërave nëntokësore
- Zgjidhja e materialit për konstruksion
- Paramasa dhe parallogarit
-

7. Hapesirave publike dhe parqeve

Projekti i hapesirave publike dhe parqeve duhet të përmbaj incizimin e gjeodezik me të gjitha të dhënata, përshkrimin teknik të detajuar me mënyrën e ekzekutimit, paramasën dhe parallogarin e punimeve dorëzohet me çmime dhe pa çmime), bazat, prerjet, dukjet, mjetet dhe pajisjet dhe detajet e ekzekutimit për të gjitha pjesët si dhe kërkesat tjera që kërkojnë normat dhe standardet për atë lloj projekti. Në kuadër të projektit të shqyrtohet edhe përcjellja e ujërave atmosferik si dhe ruajtja e ambijentit.

○ PJESA GRAFIKE

- Përshkrimi teknik dhe kushtet teknike
- Incizimi gjeodezik
- Detalet e ambijenteve P 1:50
- Detalet e stazave P 1:50
- Paramasa dhe parallogarit

8. Detajim i projekteve të ndryshme

Në disa raste kur projektet që ekzekutohen vijnë nga burime të tjera (pra jo nga kjo kontratë) mund të lindë nevoja për detajim të mëtejshëm të këtyre projekteve. Gjatë realizimit të kësaj pune duhet te merret parasysh ruajtja e frysë arkitektonike te projektit primar dhe te gjitha detajimet duhet te kryhen ne bashkëpunim me projektuesin fillestar (kur është e mundur) dhe me projekt menaxherin e projektit ne fjale. Detajimi i projekteve ose dhënia e ekspertizës për detajimin e këtyre projekteve mund te kryhet kur te jete e nevojshme (me kërkesë te menaxherit te projektit) dhe sa here qe Komuna e Mamushës të ketë një nevojë të tillë.

Tabela e pjesëve grafike duhet të ketë logon e Komunës si investues dhe hapësirën e aprovimit nga menaxherët e projektit të investuesit ndërsa, nga ana e projektuesit logon e projektuesit, menaxherin e projektit dhe pjesëmarrësit në projekt. Hartuesi i projektit gjatë projektimit duhet të konsultohet me organin mbikëqyrës dhe të merren për bazë udhëzimet qe jep ky organ.

Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë për :

- afati kohor i kthimit-dorëzimit të projekteve ideore, nga momenti i porosisë nga Komuna e Mamushës, (duhet të dorëzohet maksimumi për 10 ditë),

- afati kohor i kthimit-dorëzimit të **projekteve ekzekutive**, nga momenti i porosisë nga Komuna e Mamushës, (duhet të dorëzohet maksimumi për 20 ditë).

Forma e dorëzimit të projektit

- Faza fillestare – Projekt skica për përgjedhjen e projektit më të pranueshëm nga menaxheri i projektit (ose nëse është nevoja nga grup ekspertesh, punonjës në komunë)
- Faza e parë - Projekt i ideor i cili duhet të merr pëlgimin nga Drejtoria e Urbanizmit,
- Faza e dytë - Projektet kryesore komplet (me të gjitha fazat) të cilin e pranon komuna e Mamushës.

Projekti kryesor me të gjitha elementet e kërkuar sipas dokumentacionit tenderues duhet te punohet në 5 (pesë) kopje, lidhje te fortë A4 dhe CD. Forma elektronike duhet të jetë në versionin " PDF dhe DWG file "), në gjuhën shqipe .

Në momentin e dorëzimit të projektit të gjitha drejtat mbi projektin barten te porositësi i projektit- Komuna e Mamushës

Vërejtje: Paramasat për secilin projekt duhet të dorëzohen në dy gjuhe Shqipe dhe Serbe, ndërsa për projekte me vlera të mëdha edhe në gjuhën angleze.

| A Hartimi i projekteve ideore - duke përfshi edhe inçizimin e gjendjes ne teren. | | Njësia | Sasia |
|---|---|----------------|--------------|
| Emri i objektit ndërtimor | | | |
| 1 | Punimi i projektit ideor - arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit. | m ² | 1 |
| 2 | Punimi i projektit ideor –faza e Statikës (konstruksioni dhe stabiliteti i objektit) | m ² | 1 |
| 3 | Punimi i projektit ideor faza e Hidroinstalimeve –(rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit). | m ² | 1 |
| 4 | Punimi i projektit ideor faza e instalimeve elektrike - energetika, instalimi i rrymave të dobëta dhe të forta, rrufembrojtësit, alarmet elektronike kundër zjarrit, LAN,IT, TV, BMS, Video monitorimi, Interfonia. | m ² | 1 |
| 5 | Punimi i projektit ideor faza e instalimeve makinerike – instalimet ngrohjes së objektit, stacionet termike, klimatizimi, ventilimi dhe instalime tjera makinerike. | m ² | 1 |
| 6 | Punimi i projektit ideor – RREGULLIMI I PARTEREVE / duke perfshi edhe inçizimin e gjendjes ne teren. | m ² | 1 |

Hartimi i projekteve kryesore - palir - duke përfshi edhe inçizimin e gjendjes ne teren.

| | | | |
|---|--|----------------|---|
| 1 | Punimi i projektit kryesor palir - Arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit. | m ² | 1 |
| 2 | Punimi i projektit kryesor palir - Konstruksioni dhe stabiliteti i objektit (llogaria statike). | m ² | 1 |
| 3 | Punimi i projektit kryesor palir - Shkallevë emeregjente te objekteve nga konstruksioni i çelikut apo betonit. | cope | 1 |

| | | | |
|----|---|-------|---|
| 4 | Punimi i projektit kryesor palir të Hidroinstalimeve - ujësjellësi, kanalizimi. | m^2 | 1 |
| 5 | Punimi i projektit kryesor palir të instalimeve elektriqe - energjetika instalimi i rrjave të dobëta dhe të forta, rrufembrojtësit, alarmet elektronike kundër zjarrit, LAN, IT, TV, BMS, Video monitorimi, Interfonia. | m^2 | 1 |
| 6 | Punimi i projektit kryesor palir të instalimeve elektriqe - Trafove. | cope | 1 |
| 7 | Punimi i projektit kryesor palir të instalimeve makinerike - instalimet ngrohjes së objektit, stacionet termike, klimatizimi, ventilimi dhe instalime tjera makinerike | m^2 | 1 |
| 8 | Punimi i projektit kryesor palir të instalimeve - Ashensorëve te ndryshëm dhe shkalleve lëvizëse. | cope | 1 |
| 9 | Punimi i projektit kryesor – RREGULLIMI I PARTEREVE. / duke përfshi edhe incizimin e gjendjes ne teren. | m^2 | 1 |
| 10 | Punimi i projektit kryesor – Rrënimi i objekteve. | m^2 | 1 |

Hartimi i projekteve për renovim - duke përfshi edhe incizimin e gjendjes ne teren.

| | | | |
|----|---|-------|---|
| 1 | Incizimi detal i objekteve ekzistuese (arkitektura), përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese, pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m^2 | 1 |
| 2 | Incizimi detal i objekteve ekzistuese-STATIKA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m^2 | 1 |
| 3 | Incizimi detal i objekteve ekzistuese-ELEKTRIKA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m^2 | 1 |
| 4 | Inqizimi detal i objekteve egzistuese-MAKINERIA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m^2 | 1 |
| 5 | Inqizimi detal i objekteve egzistuese-UJESJELLESI DHE KANALIZIMI, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m^2 | 1 |
| 6 | Inqizimi i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m' | 1 |
| 7 | Inqizimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimit, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m' | 1 |
| 8 | Punimi i projektit renovues – ARKITEKTURA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim. | m^2 | 1 |
| 9 | Punimi i projektit renovues – STATIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim. | m^2 | 1 |
| 10 | Punimi i projektit renovues – ELEKTRIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim. | m^2 | 1 |



| | | | |
|----|---|----------------|---|
| 11 | Punimi i projektit renovues – HIDROINSTALIMET, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim. | m ² | 1 |
| 12 | Punimi i projektit renovues – NGROHJA QENDRORE, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim. | m ² | 1 |
| 13 | Punimi i projektit renovues të infrastrukturës – rrjet furnizues i ujësjellësit dhe përbajtjeve përcjellese. | m' | 1 |
| 14 | Punimi i projekteve renovues të infrastrukturës – rrjet i kanalizimit dhe përbajtjeve përcjellese. | m' | 1 |

| B | <i>Hartimi i projekteve për Terene Sportive te hapura - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.</i> | Njesia | Sasia |
|---|---|----------------|-------|
| 1 | Projektimi i tereneve sportive - të hapura | m ² | 1 |
| 2 | Projektimi i shesheve (me fontana, gjelbrim, parkingje, shetitore etj.) | m ² | 1 |
| 3 | Projektimi i parqeve, kendeve per femije etj. | m ² | 1 |
| <i>Hartimi i projekteve për Rrugë dhe objektet e rruges - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.</i> | | | |
| 1 | Projektim i rrugëve - me dy shirita | m' | 1 |
| 2 | Projektimi i trotuareve | m' | 1 |
| 3 | Projektimi i Urave deri 10 m | m' | 1 |
| 4 | Projektimi i Urave mbi 10 m | m' | 1 |
| 5 | Projektimi i Mureve Mbrojtëse nen 2m lartesi | m' | 1 |
| 6 | Projektimi i Mureve Mbrojtëse mbi 2m lartesi | m' | 1 |
| 7 | Projektimi i sinjalizimit te rrugëve | m' | 1 |
| 8 | Projektimi për rregullimin e nyjeve te komunikacionit, rreth-rrotullimeve etj. | cope | 1 |
| 9 | Projektimi i parkingjeve te hapura. | m ² | 1 |
| <i>Hartimi i projekteve për Trajtim te Ujerave - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.</i> | | | |
| 1 | Projektimi i Kanalizimit Fekal | m' | 1 |
| 2 | Projektimi i Kanalizimit Atmosferik | m' | 1 |
| 3 | Projektimi i Kanaleve të Hapura | m' | 1 |
| 4 | Projektimi i Rrjetit te Ujësjellsit | m' | 1 |
| 5 | Projektimi i shtratit të perroit / lumenjeve | m' | 1 |
| 6 | Objektet per trajtimin e Ujrate te Pijës | m ² | 1 |
| 7 | Projektimi i Rezervarve te Ujtitë | litra | 1 |
| 8 | Projektimi i Kanaleve Ujtitëse me elemente përcjellese | m' | 1 |

Hartimi i projekteve për Rrjetet Elektrike, Nriqimet Publike - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.

| C | <i>Punimi i Elaborateve per nevoja te Autoritetit Kontraktues (Varesisht prej detyres projektuese dhe nevojave te AK)</i> | | Njesia | Sasia |
|---|---|--|----------------|-------|
| | Emri i objektit ndërtimor | | | |
| 1 | Shqyrtime Gjeomekanike - Shpimet dhe studimet gjeomekanike dhe përgatitja e elaboratit gjeomekanik. | | m' | 1 |
| 2 | Shqyrtime Gjeomekanike - Shpimet dhe studimet gjeomekanike dhe përgatitja e elaboratit gjeomekanik. | | m ² | 1 |
| 3 | Hartimi i Elaboratit per Matje gjeodezike. | | m' | 1 |
| 4 | Hartimi i Elaboratit per Matje gjeodezike. | | m ² | 1 |

Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i sherbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata është kontratë kornizë për **36 muaj** e cila hynë në fuqi me **17.10.2023** dhe përfundon në datën **16.10.2026**

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **30 ditë** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: **Vendi kryesor i realizimit është në Mamushë dhe në zyre të O.E. fitues dhe në vendet e përcaktuara nga AK. Projektet duhet të dorëzohen në Mamushë.**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **20,000.00 €; Njëzetmijë** Euro për periudhën prej 36 muajve.

3.2 Çmimi për njësi i të gjitha pjesëve të paraqitura në përshkrimin e çmimit të tenderit është **2.83 €. Dy Euro e tetëdhjetë e tre Eurocent.**

3.3 Çmimi i poentuar është: **1.10 €; Një Euro e dhjetë Eurocent.**

3.4 Çmimi i përmendor në Nenin 3.2 më sipër është çmimi i llogaritur për njësi (1) i të gjitha pozicioneve për hartimin dhe dorëzimin e projekteve. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë gjithë kohës së kontratës.

3.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) [shëno çdo dispozitë tjeter të dosjes së tenderit].

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

| Emri: | Fidan Salihu | Emri: | Gazmend Gashi |
|-------------|--|-------------|---|
| Pozita: | Arkitekt | Pozita: | Udhëheqës i sektorit të Prokurimit |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data: | 17.10.2023 | Data: | 17.10.2023 |
| Vula: |  | Vula: |  |

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës:³ 626-23-6372-2-2-1/C146

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

³ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesin.

1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e dekluarar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrin nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënes së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënen e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontratohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrin Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraton pa autorizim me shkrin nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkasat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontrakteve ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimitari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsy:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmembush detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvçese kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofreusit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofreusin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimi, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmembush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrëthanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të

plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjeter me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgjegjësuar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpërt kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofri i Shërbimeve

10.1 Ofri i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofrit të Shërbimeve shumat që duhet t'i paguhen në ndonjë certifikatë t'i lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit t'i afatit t'i fundit;
- b. vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve t'i përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofri i Shërbimeve është i paaftë t'i kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do t'i bëhet pa paragjykim për ndonjë t'i drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofrit të Shërbimeve.

10.3 Në rast t'i ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofrit e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofrit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofrit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do t'i kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofri i Shërbimeve duhet t'i pajtohet me urdhërat administrative t'i dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofri i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përej fushëveprimit t'i kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje t'i kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit t'i urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do t'i pezullohet për shkak t'i këtij njoftimi.

11.3 Ofri i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe t'i veprojë sipas t'i gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do t'i sigurojë që personeli i tij, t'i afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë t'i tij gjithashtu t'i respektojnë dhe t'i veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofri i Shërbimeve do t'i trajtojë t'i gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do t'i shpëtojë për aq kohë sa t'i jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit t'i kontratës, t'i batojë ose t'i zbulojë ndonjë t'i dhënë t'i kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim t'i Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofri i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, t'i gjithë personat ose korporatat e tillë do t'i janë së bashku dhe veçmas t'i detyruar për t'i përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për t'i vepruar në emër t'i tij për qëllimet e kësaj kontrate do t'i ketë autoritetin për t'i lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do t'i ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim t'i Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofri i Shërbimeve do t'i punësojnë personelin kyç t'i identifikuara në tenderin e tij për t'i kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë t'i një kërkesë me shkrim dhe t'i arsyetuar, autoriteti kontraktues mund t'i kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do t'i miratojë çdo zëvendësim t'i personelit kryesor t'i propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë t'i barabarta ose më t'i mirë se ato t'i identifikuara.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do t'i ofrojë ofrit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion t'i saj, t'i cilat mund t'i janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente t'i tillë duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund t'i periudhës së zbatimit t'i detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do t'i bashkëpunojë sa më shumë t'i jetë e mundur me ofrit e shërbimit për t'i siguruar informacion që ky i fundit mund t'i kërkojë në mënyrë t'i arsyeshme për t'i kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do t'i caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do t'i jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i sherbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha sherbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së sherbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit sherbime parandalon përdorimin e zakonshëm të sherbimeve në tërsi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Sherbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të sherbimeve. Ofruesi i sherbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garacioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i



shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërbime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërbimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbilej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës:⁴ 626-23-6372-2-2-1/C146

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| | | |
|--|-----------|---|
| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | <i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i> Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK mund të bëhet vetëm me pelqimin e të dy palëve kontraktuese. |
| Përshkrimi i nenit | Nr. Nenit | Kushtet dhe detyrimet |
| Ligi i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikson do të ketë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe. |
| Siguria ekzekutimit | 3.1 | Siguria e ekzekutimit është: 4,000.00 € për periudhën prej 37 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës. |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 4.1 | Përgjegjësia e kontraktuesit është në rast të shkaktimit të dëmeve në persona, staf apo objekte për rrith. Operatori Ekonomik është përgjegjës për sigurimin e punëtoreve të tij dhe do ti bartë të gjitha pasojat në rast të ndonjë lëndimi gjatë ekzekutimit të shërbimeve, gjatë transportit në objektet institucionale dhe në të gjitha vendet e matjeve. |
| Cilësia Shërbimeve | 5.0 | Shërbimet duhet të kenë cilësi të lartë dhe duhet ti përbahen me përpikëri specifikacionit teknik në dosje të tenderit. |
| Inspektimi testimi | 6.1 | Menaxheri i Projektit: Inspektimi i matjeve duhet të bëhet nga njësia e pranimit me rastin e kryerjes së shërbimit nga kontraktuesi. Në rast të vërejtjes do të njoftohet menaxheri i projektit i cili do të caktohet me vendim nga ana e ZKA-së |
| Pagesa | 7.1 | Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate me të cilën vërteton pjesën e përfunduar të shërbimeve sipas kontratës. |
| Obligimet garacionit | 8.1 | Operatori ekonomik do të ofrojë shërbime cilësore të cilat i përshtaten specifikimeve teknike në dosje të tenderit. |
| Shërbimet pas shitjes | 9.1 | Periudha për përmirësimin e defekteve është 5 ditë pas dorëzimit të kërkesës (Vërejtjes) nga ana e Menaxherit të kontratës në rast se konstatohet që shërbimi nuk i plotëson specifikat teknike. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes | 10.1 | Palët do të tentojnë që ti zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore. Sapo te shfaqet ndonjë mosmarrëveshje palët do ta njoftojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e mosmarrëveshjes dhe do ti sugjerojnë palës tjetër mbi variantin e zgjidhjes së kësaj. |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore | 11.1 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, në pajtim me legjislacionin në Kosovë. |

⁴ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesin.



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



PËRSHKRIMI I ÇMIMIT

“HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITET 2023-2026”-Ritender

Nr. I Prokurimit: 626-23-6372-2-2-1

Nr. I Prokurimit: 626-23-005-2-2-1

| Nr | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi për njësi ME TVSH € | Çmimi merr 30% të pikëve të vlerësimit |
|--|---|----------------|-------|---------------------------|--|
| A Hartimi i projekteve ideore - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren. | | | | | |
| 1 | Punimi i projektit ideor - arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit. | m ² | 1 | 0,04 € | 0,01 € |
| 2 | Punimi i projektit ideor - faza e Statikës (konstruksioni dhe stabiliteti i objektit) | m ² | 1 | 0,04 € | 0,01 € |
| 3 | Punimi i projektit ideor faza e Hidroinstalimeve –(rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit). | m ² | 1 | 0,04 € | 0,01 € |
| 4 | Punimi i projektit ideor faza e instalimeve elektrike - energetika, instalimi i rrymave të dobëta dhe të forta, rrufembrojtësit, alarmet elektronike kundër zjarrit, LAN, IT, TV, BMS, Video monitorimi, Interfonia. | m ² | 1 | 0,04 € | 0,01 € |
| 5 | Punimi i projektit ideor faza e instalimeve makinerike – instalimet ngrohjes së objektit, stacionet termike, klimatizimi, ventiliimi dhe instalime tjera makinerike. | m ² | 1 | 0,04 € | 0,01 € |
| 6 | Punimi i projektit ideor – RREGULLIMI I PARTEREVE / duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren. | m ² | 1 | 0,04 € | 0,01 € |
| A Hartimi i projekteve kryesore - palir - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren. | | | | | |
| 1 | Punimi i projektit kryesor palir - Arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit. | m ² | 1 | 0,04 € | 0,01 € |
| 2 | Punimi i projektit kryesor palir - Konstruksioni dhe stabiliteti i objektit (llogaria statike). | m ² | 1 | 0,04 € | 0,01 € |
| 3 | Punimi i projektit kryesor palir - Shkallevë emeregjente te objekteve nga konstruksioni i çelikut apo betonit. | cope | 1 | 0,04 € | 0,01 € |
| 4 | Punimi i projektit kryesor palir të Hidroinstalimeve - ujësjellësi, kanalizimi. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 5 | Punimi i projektit kryesor palir të instalimeve elektrike - energetika instalimi i rrymave të dobëta dhe të forta, rrufembrojtësit, alarmet elektronike kundër zjarrit, LAN, IT, TV, BMS, Video monitorimi, Interfonia. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 6 | Punimi i projektit kryesor palir të instalimeve elektrike - Trafove. | cope | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 7 | Punimi i projektit kryesor palir të instalimeve makinerike - instalimet ngrohjes së objektit, stacionet termike, klimatizimi, ventiliimi dhe instalime tjera makinerike | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 8 | Punimi i projektit kryesor palir të instalimeve - Ashensoreve te ndryshem dhe shkallevë levizese. | cope | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 9 | Punimi i projektit kryesor – RREGULLIMI I PARTEREVE. / duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 10 | Punimi i projektit kryesor – Rrenimi i objekteve. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| A Hartimi i projekteve për renovim - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren. | | | | | |
| 1 | Incizimi detal i objekteve ekzistuese (arkitektura), përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese, pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 2 | Inqizimi detal i objekteve egzistuese-STATIKA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 3 | Inqizimi detal i objekteve egzistuese-ELEKTRIKA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 4 | Inqizimi detal i objekteve egzistuese-MAKINERIA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 5 | Inqizimi detal i objekteve egzistuese-UJESJELLESI DHE KANALIZIMI, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 6 | Inqizimi i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m' | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 7 | Inqizimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimit, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik. | m' | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 8 | Punimi i projektit renovues – ARKITEKTURA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 9 | Punimi i projektit renovues – STATIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 10 | Punimi i projektit renovues – ELEKTRIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 11 | Punimi i projektit renovues – HIDROINSTALIMET, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 12 | Punimi i projektit renovues – NGROHJA QENDRORE, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim. | m ² | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 13 | Punimi i projektit renovues të infrastrukturës – rrjeti furnizues i ujësjellësit dhe përbajtjeve përcjellese. | m' | 1 | 0,03 € | 0,01 € |
| 14 | Punimi i projekteve renovues të infrastrukturës – rrjeti i kanalizimit dhe përbajtjeve përcjellese. | m' | 1 | 0,03 € | 0,01 € |

| | | | | TOTALI (A) - 30% : | 0,30 € |
|----------|---|----------------|-------|---------------------------|--|
| B | Hartimi i projekteve për Terenc Sportive të hapura - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren. | Njësia | Sasia | Çmimi për njësi ME TVSH € | Çmimi merr 50% të pikëve të vlerësimit |
| 1 | Projektimi i tereneve sportive - të hapura | m ² | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 2 | Projektimi i shesheve (me fontana, gjetrim, parkingje, shetitore etj.) | m ² | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 3 | Projektimi i parqeve, kendeve per femije etj. | m ² | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| B | Hartimi i projekteve për Rrugë dhe objektet e rruges - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren. | | | | |
| 1 | Projektimi i rrugëve - me dy shirita | m' | 1 | 0,60 € | 0,30 € |
| 2 | Projektimi i trouareve | m' | 1 | 0,20 € | 0,10 € |
| 3 | Projektimi i Urave deri 10 m | m' | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 4 | Projektimi i Urave mbi 10 m | m' | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 5 | Projektimi i Mureve Mbrotëse neu 2m lartesi | m' | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 6 | Projektimi i Mureve Mbrotëse mbi 2m lartesi | m' | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 7 | Projektimi i sinjalizimit te rrugëve | m' | 1 | 0,10 € | 0,05 € |
| 8 | Projektimi për rregullimin e nyjeve te komunikacionit, rrith-rrotullimeve etj. | cope | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 9 | Projektimi i parkingjeve te hapura. | m ² | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| B | Hartimi i projekteve për Trajnim te Ujerave - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren. | | | | |
| 1 | Projektimi i Kanalizimit Fekal | m' | 1 | 0,10 € | 0,05 € |
| 2 | Projektimi i Kanalizimit Atmosferik | m' | 1 | 0,10 € | 0,05 € |
| 3 | Projektimi i Kanaleve të Hapura | m' | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 4 | Projektimi i Rrjetit te Ujësjellisit | m' | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 5 | Projektimi i shtraitit të perroit / lumenjeve | m' | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 6 | Objektet per trajtinin e Ujave te Pijës | m ² | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 7 | Projektimi i Rezervarve te Ujite | litra | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 8 | Projektimi i Kanaleve Ujite se me elemente përcjellese | m' | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| 9 | Projektimi i Pendave te Ujite | m' | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| B | Hartimi i projekteve për Rrjetet Elektrike, Nriqimet Publike - duke perfshi edhe ingjizimin e gjendjes ne teren. | | | | |
| 1 | Projektimi i rrjetit elektrike dhe ndriçimit publik | m' | 1 | 0,02 € | 0,01 € |
| | | | | TOTALI (B) - 50% : | 0,72 € |
| C | Punimi i Elaborateve per nevoja te Autoritetit Kontraktues (Varesisht prej detyres projektuese dhe nevojave te AK) | Njësia | Sasia | Çmimi për njësi ME TVSH € | Çmimi merr 20% të pikëve të vlerësimit |
| 1 | Shqyrtim Gjeomekanike - Shpimet dhe studimet gjeomekanike dhe përgatitja e elaboratit gjeomekanik. | m' | 1 | 0,05 € | 0,01 € |
| 2 | Shqyrtim Gjeomekanike - Shpimet dhe studimet gjeomekanike dhe përgatitja e elaboratit gjeomekanik. | m ² | 1 | 0,05 € | 0,01 € |
| 3 | Hartimi i Elaboratit per Matje gjeodezike. | m' | 1 | 0,25 € | 0,05 € |
| 4 | Hartimi i Elaboratit per Matje gjeodezike. | m ² | 1 | 0,05 € | 0,01 € |
| | | | | TOTALI (C) - 20% : | 0,08 € |

| Rikapitullim i Përgjithshëm | | Çmimi i pa peshuar | Çmimi total i peshuar |
|--|--|--------------------|-----------------------|
| 1 | Totali nga (A): i projektimit për të gjitha pozicionet | 30% | 0,99 € |
| 2 | Totali nga (B): i projektimit për të gjitha pozicionet | 50% | 1,44 € |
| 3 | Totali nga (C): i projektimit për të gjitha pozicionet | 20% | 0,40 € |
| Çmimi total (pa peshuar ne baze të rëndësishëm dhe frekuencës): | | | 2,83 € |
| Çmimi i Përgjithshem i peshuar (ofertat do te vleresohej ne baze te kesaj vlere). Kjo ështe vlera e cila duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe do te lexohet gjate hapjes publike. | | | 1,10 € |
| Operatorët Ekonomik me Çmime jo normalisht të ulët dhe ata qe ofrojnë çmire të larta të cilët nuk përkijn me çmimet e tregut do të eliminohen automatikisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Pagesat do të bëhen vetëm në bazë të porosisë nga AK (Detyrës Projektuese e cila gjendet ne aneksin I të DT). | | | |

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK | | | |
|------------------------------------|--|--|---------------------------|
| EMRI I OPERATORIT EKONOMIK | | | Alpo SHPK & Enggroup SHPK |
| ADRESA E PLOTE | | | Hajvali, Prishtinë |
| PERFAQESUAR NGA: | | | |
| EMRI & MBIEMRI | | | Behar Zeqiri |
| POZITA | | | Drejtësor |
| NËNSHKRIMI | | | |
| DATA | | | 12.07.2023 |
| VULA | | | |

